

V E N D I M
Nr.123, datë 27.2.2003

**PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM , PËR PËRGJEGJËSITË NDAJ PALËVE TË TRETA,
TË MJETEVE MOTORIKE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar me ligjin nr.8767, datë 5.4.2001, me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Institucionet buxhetore, për fondet limit, të miratuara në Buxhetin e Shtetit të vitit 2003, të përdorin procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë”, me INSIG sh.a. për sigurimin e detyrueshëm, për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, të mjeteve të tyre motorike.

2. Primi, që INSIG sh.a. do të arkëtojë nga institucionet buxhetore, të jetë vlera e primit të pastër, shtuar vlerën e shpenzimeve minimale administrative, të përcaktuara me urdhër të Ministrisë të Financave.

3. Ngarkohen institucionet buxhetore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano